



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

**U R D H Ë R
NR. 291 DATË 21. 10. 2004**

**PËR
FUNKSIONIMIN E PROKURORISË PËR KRIME TË RËNDA DHE MARRËDHËNIET
E SAJ ME E TJERA DHE ME POLICINË GJYQËSORE**

Me synim,

- për të përmirësuar funksionimin e Prokurorisë për Krime të Rënda, si dhe;
- për të rritur efektivitetin në ndjekjen penale të krimeve të rënda në fokusin e ndryshimit të kompetencës lëndore të saj;

Në mbështetje, të nenit 8 pika 2 e vijues të ligjit Nr. 8737 datë 12. 02. 2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë ne Republikën e Shqipërisë", si dhe të ligjit Nr. 9110 datë 24. 07. 2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave për Krime të Rënda",

U R D H Ë R O J :

1. Prokurorët për krime të rënda i ushtrojnë funksionet pranë Gjykatës për Krime të Rënda. Ata, ushtrojnë ndjekje penale, përfaqësojnë akuzën në gjyq, si dhe urdhërojnë dhe mbikëqyrin ekzekutimin e vendimeve penale, në të gjithë territorin e vendit, për krime të rënda që parashikon neni 75/a i K. Pr. Penale¹.

Prokurorët e Prokurorive të rretheve gjyqësore, prokurorët ushtarak dhe policia gjyqësore e seksioneve dhe shërbimeve të të gjithë llojeve të Policive, kur marrin dijeni për krime të rënda ose për vepra penale të lidhura me to, njoftojnë menjëherë Prokurorinë për Krime të Rënda. Krahas njoftimit, prokurorët e taks forcës në rrethet gjyqësore ku ato ushtrojnë funksionet, prokurorët e rretheve gjyqësore dhe prokurorët ushtarak duhet të drejtojnë dhe të kontrollojnë kryerjen e të gjithë veprimeve hetimore, deri në angazhimin e prokurorëve për krime të rënda në drejtimin dhe kontrollin e hetimeve ose deri në marrjen e vendimit për kalimin e akteve Prokurorisë për Krime të Rënda.

3. Prokuroria për Krime të Rënda të marrë masat e duhura organizative

¹ Shih. nenin 4 të ligjit nr 9276 datë 14. 9. 2004 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr 7905 datë 21. 03. 1995" - K Pr. Penale i Republikës së Shqipërisë "i ndryshuar" i hyrë ai fuqi me 22. 10 2004. i FZ Nr, 69. viti 2004.

për të mbuluar të gjithë ngjarjet kriminale dhe rastet e flagrancës në kompetencë lëndore e tokësore të saj, duke ushtruar funksionet e drejtimit dhe kontrollit të hetimeve paraprake të kryera nga oficerët e policisë gjyqësore të seksionit pranë saj dhe/ose nga oficerët e shërbimeve të specializuara të policisë gjyqësore. Në këto raste, kur prokurori për krime të rënda ka njoftuar se do të marrë pjesë në kryerjen e veprimeve të para hetimore, policia gjyqësore, prokurorët e rretheve gjyqësore dhe/ose prokurorët ushtarak të marrin masat e duhura që gjurmët dhe sendet që i përkasin veprës penale të ruhen dhe gjendja e vendngjarjes dhe e sendeve të mos ndryshojë para ndërhyrjes së prokurorit për krime të rënda.

4. Shërbimet e policisë gjyqësore të të gjithë llojeve të Policive, në të gjithë rastet që kryejnë veprime të para hetimore me iniciativë dhe/ose arrestime në flagrancë apo ndalimeve për krime të rënda, të referojnë drejtpërdrejtë në Prokurorinë për Krime të Rënda, për të mundësuar, sa më shpejt, ushtrimin prej saj të funksionit të ndjekjes penale. Shërbimet e policisë gjyqësore që kanë kryer arrestimin në flagrancë ose ndalimin, brenda 24 orëve, të vënë në dispozicion të Prokurorisë për Krime të Rënda të arrestuarin në flagrancë ose të ndaluarin në dhomat e paraburgimit të Burgut 313 në Tiranë.
5. Përjashtim nga urdhërimet e pikave 3 e 4 më sipër, mund të bëhet në rastet kur ngjarjet kriminale dhe/ose rastet e flagrancës në kompetencë të Prokurorisë për Krime të Rënda ndodhin në Prokuroritë e rretheve gjyqësore Korçë, Kolonjë, Dibër, Bulqizë, Tropojë, Pukë e Kukës ose në ndonjë Prokurori rrethi gjyqësor tjetër dhe prokurorët për krime të rënda janë në pamundësi objektive për ti mbuluar. Në këto raste, drejtuesi i Prokurorisë së rrethit gjyqësor ose prokurori ushtarak, duhet të njoftohen menjëherë nga drejtuesi i Prokurorisë për Krime të Rënda për pamundësinë objektive në mbulimin e ngjarjes kriminale dhe/ose të rastit të flagrancës, si dhe pasi marrin konfirmimin nga drejtori i Drejtorisë K/Krimit të Organizuar i kësaj Zyre, kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, caktojnë masën e sigurimit personal dhe menjëherë aktet ia kalojnë për kompetencë Prokurorisë për Krime të Rënda, mbështetur në nenin 28 të K. Pr. Penale.
6. Drejtoria Kundër Krimit të Organizuar e kësaj Zyre, të udhëheq nga ana metodike, të ndihmojë dhe të kontrollojë ushtrimin e ndjekjes penale nga prokurorët për krime të rënda, si dhe të ndihmojë për bashkërendimin e saj me hallka të tjera të Prokurorisë dhe me

në Policinë e Shtetit dhe në Policinë e llojeve të tjera.

7. Prokurorët e rretheve gjyqësore dhe prokurorët ushtarak, menjëherë të bëjnë kalimin e akteve ose shpallin moskompetencën², përkatësisht për kallëzimet penale të paregjistruara dhe procedimet penale në fazën e hetimeve paraprake, për krime të rënda, që në datë 22 tetor 2004 mbarten në Prokuroritë e rretheve gjyqësore dhe prokurorët ushtarak. Gjithashtu, prokurorët për krime të rënda, menjëherë të bëjnë kalimin e akteve ose shpallin moskompetencën³, përkatësisht për kallëzimet penale të paregjistruara dhe procedimet penale në fazën e hetimeve paraprake, për vepra penale që nuk janë më në kompetencën lëndore të tyre.
8. Për të ndjekur e kontrolluar zbatimin e këtij urdhëri ngarkohen drejtuesit e Prokurorive të shkallës së parë, drejtuesit e strukturës së Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, prokurorët dhe drejtuesit e Prokurorive të të gjithë niveleve, drejtuesit e të gjithë strukturave të shërbimeve të policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit dhe të Policive të tjera, si dhe oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore të seksioneve dhe të shërbimeve të policisë gjyqësore në të gjithë nivelet.
9. Mospërmbushja e detyrave të përcaktuara në këtë urdhër, përbën shkelje të disiplinës në punë.
10. Me këtë urdhër të njihen prokurorët, drejtuesit e Prokurorive të të gjithë niveleve, oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore dhe drejtuesit e strukturave të shërbimeve të policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit dhe në Policinë e llojeve të tjera.
11. Urdhëri Nr. 227 datë 19. 12. 2003 "Për funksionimin e prokurorive për krime të rënda dhe rnarëdhëniet e saj me hallkat e tjera të sistemit të prokurorisë", shfuqizohet për aq sa bie në kundërshtim me këtë urdhër.
12. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

PROKURORI I PERGJITHSHËM

THEODHORI SOLLAKU

² Shih nenet 28, 84 e vijues të K. Pr. Penale dhe nenin 75/a të ndryshuar të K. Pr. Penale

³ Shih po aty